



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN
BELEDIYESI



Zyra e Prokurim

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), si dhe në pajtim me nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, Rregullave për Prokurimin Publik / Nr.001/2022, në bashkëpunim me dhe propozim të Përgjegjësit të Njësisë Kërkuese dhe Zyra e Prokurim Publik, /Nr.A01, merr:

V E N D I M Për Menaxher

I. Emërimin e Menaxherit të Kontratës

- I. Menaxher i Kontratës caktohet **Bashkim Maliqi për Komunën e Gjilanit** Nëse natyra e aktivitetit ka të bëjë me punë atëherë rekomandohet që Menaxheri me qene profesionist i fushës dominuese në kuadër të aktivitetit)

1. Menaxheri i Kontrates për "Furnizim me artikuj ushqimor (LOT6)"Furnizim me bukë dhe brumera te tjera –niveli qendror dhe lokal me nr. të Prokurimit :UA/2016-24-8838-1-1-1, si dhe nr.kontratës:UA/2016-24-8838-1-1-1\C627, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës në pajtim me Neni 70 të Rregullave për Prokurimin Publik Nr.001/2022, si dhe Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës.

Përgjegjësitë dhe funksionet e Menaxherit të Kontratës, janë që të :

- Në pajtim me nenin 70.10 të Rregullave për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të filloi me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë Menaxheri i kontratës brenda afatit duhet të krijoj Planin për Menaxhim të kontratës duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës;
- Menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
- Sigurojë që Operatori Ekonomik përmbushë të gjitha obligimet e performances apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Operatori Ekonomik dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë që Komuna i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- Sigurojë se ka kontroll adekuate të kostove, cilësisë dhe kohës;
- Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së Kontratës;
- Sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik;
- Bëj vlerësimin e performances se operatorit ekonomik në sistem të prokurimit elektronik pas përfundimit të kontratës
- Nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës dhe legjislacionin për natyrën e aktivitetit ;